

# ROLI I ARKITEKTURES DHE DIZAJNIT URBAN NE RIVITALIZIMIN DHE INTEGRIMIN E IDENTITETIT DHE FUNKSIONEVE TE REJA. PRISHTINA KRYEQYTETI I RI EUROPIAN (Abstrakti)

Visar Q. Haxhibeqiri,  
Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit Urban  
Universiteti Polis  
Tiranë, Republika e Shqipërisë

*Objektivat dhe qëllimet – Sheshi Zahir Pajaziti, Nënë Tereza, Skenderbeu dhe sheshi Pavarësia janë një ndër sheshet më të mëdha dhe më të frekuentueshme në Prishtinë. Kjo ndoshta si pasojë e vendosjes së tyre në kuadër të Qendrës së ngushtë të Qytetit. Edhe pse këto sheshe ndodhen afër njëra tjetrës ato, për një numër arsyesh vazhdojnë të funksionojnë si sheshe të ndara nga njëra tjetra. Qëllim i këtij projekti, do të jetë inkorporimi i këtyre shesheve në një të vetëm. Do të thotë tash e tutje këto sheshe do të bashkohen dhe do të funksionojnë si një tërësi e vetme. Qëllimi i konceptit fillestar është ai i trajtimit të Shesheve Zahir Pajaziti, Nënë Tereza, Skenderbeu si dhe sheshi Pavarësia si një tërësi pothuajse unike që ka lindur dhe vazhdon të zhvillohet në një bosht qendror në kuadër të zemrës së qytetit. Trajtimi i të katër shesheve si një tërësi unike, por me identitete të theksueshme dhe të dallueshme njëherit është dhe qëllimi kryesor i projektit tim. Si i tillë, projekti tenton që këtë bosht ta shndërroj në Sheshin Kryesorë (qendrorë) të kryeqytetit Prishtina. Nëse Qendra e qytetit është identifikuese e denjë e një qyteti, atëherë sheshi kryesor do të jetë kualiteti primar e themelor i qendrës së qytetit. Thënë më ndryshe në mënyrë krahasimore duke treguar rëndësinë që do ketë ky shesh në kuadër të qytetit por edhe të shtetit, mund ta përkufizojmë në sloganin: kryeqyteti për shtetin – si sheshi qendrorë për kryeqytetin. Përpos, ndërhyrjeve në sferën e Dizajnit Urban do të prezantohet dhe projektin e një ndërtesë (objekt) të ri arkitektonik, i cili do të ngërthen në vetvete të gjitha funksionet të cilat i mungojnë këtij sheshi, por do të jap dhe zgjidhje për funksionet problematike të Shesheve në fjalë. Megjithatë, kjo çështje mbetet të shihet edhe njëherë pas përfundimit të Fazës së analizave.*

*Fjalet kyçe—Dizajni Urban, Qyteti, Qendra e qytetit, Sheshi, Historia, Funkzioni etj.*

## I. OBJEKTIVAT

Objektivat e përgjithshme

- Shprehje e identitetit të qytetit përmes vlerave kulturo-historike - gërshetim i së kaluarës dhe të ardhmes - vendosje e bazamentit për të ardhmen.
- Mundësi për qasje të drejtë dhe të njëjtë edhe në zonat tjera urbanistike të qytetit

- Ngritje e nivelit të jetës urbane për banorët aktual
- Shfrytëzim dhe rregullim racional i hapësirave të lira
- Krijimi i ambientit të qëndrueshëm urban.

Objektivat e veçanta

- Zhvillimi i imazhit të Sheshit Bosht\*) në një qendër qytetare, qendër kulturore e tregtare për kryeqytetin e Prishtinës dhe gjithë Kosovës.
- Krijimi i një bulevardi këmbësorë por të gjallë, peizazh, e megjithatë urban, të gjitha bashkë, hapësirë të përdorshme për gjithë vitin, dhoma të ndryshme urbane me karakter të dryshëm dhe të dallueshëm.
- Krijimi i aktiviteteve për sheshin për 24 orë gjatë 7 ditëve të javës.
- Ofrimi i një hapësire ngjarjesh festive në ambiente të hapura.
- Krijimi i një destinacioni atraktiv brenda qytetit për banorët dhe vizitorët.

## II. PYETJET HULUMTUESE DHE HIPOTEZAT

Pyetjet, të cilat adreson në mënyrë konceptuale projekti im, marrin shkas nga transformimet e zhvillimet nëpër të cilat po kalon vendi ynë dhe veçanërisht kryeqyteti.

- Cili do të ishte ai shesh që do të prezantonte më së miri këto ndryshime?
- Si do të jetë e mundur që një shesh i tillë jo vetëm të vinte në skenë, por edhe të shkundte dhe të kontribuonte në këtë zhvillim?
- Si mund të bëhet që veçantia e sheshit të ruhet, e për më tepër të theksohet?
- Si mund të nxirret edhe më shumë në pah historia e tij? A mund të fitojë Sheshi Bosht famën e shesheve të tjera botërore.
- Si do të mund t'i shërbejnë Sheshi Bosht dhe hapësira përreth tij jetës së qytetarëve?

- A duhet të jetë ai i hapur në maksimumet e mundësive të tij, në mënyrë që turma të mëdha qytetarësh të mund të vijnë për të diskutuar, për të mbështetur e protestuar, si edhe për të organizuar një kombinim të gjerë manifestimesh dhe ngjarjesh kulturore?

Këto pyetje kryesishtishin thelbësoret, të cilat herë herë u ndryshuan, u deformuan, u rishkruan deri sa më në fund, pyetjet nga fjalët morën dhe formën fizike të një projekti i cili është përshkruar në kapitullin e fundit të këtij punimi.

### III. VESHTRIM I PERGJITHSHEM

Tema që trajtohet është: “Roli i arkitekturës dhe dizajnit urban në rivitalizimin dhe integrimin e identitetit dhe funksioneve të reja”. Po ta analizojmë pak më ngadalë, temën si të tillë atëherë vërejmë tri fjalë kyçe: *Arkitektura, Dizajni Urban, dhe identiteti*.

Nisur nga kjo, punimi orientohet në dy fusha kryesore të kërkimit, atë të identitetit në arkitekturë e dizajn urban, si dhe në fushën e dizajnit urban në përgjithësi.

Pjesa e parë përfshinë nocione dhe tematike të ndryshme në fushën e Dizajnit urban, duke filluar nga përkufizimet mbi dizajnin urban dhe vazhdon me principet e tij themelore, pastaj hapësirat publike, sheshet, bulevardet, peizazhi etj.

Pjesa e dytë, zbulon rolin e kujtesës dhe imagjinatës në perceptimin e ambientit të ndërtuar, dhe kontributi i kornizave kulturore në formacione të identiteteve urbane, shoqërore dhe individuale. Si rrjedhojë, në pjesën tekstuale kam sjellë një pjesë të debatit profesionist intelektual që ka kohë që zhvillohet në mesin e çarqeve të ndryshme akademike.

### IV. ANALIZA TEORIKO-FILOZOFIKE E RASTEVE TË ZGJEDHURA PËR STUDIM

Në kuadër të rasteve të zgjedhura për studim në hartimin e tezës së diplomës, duke pas parasysh natyrën e deri diku edhe problematikën e ngjashme të shqyrtimit, kam zgjedhë tri raste nga *Konkursi ndërkombëtar për rigjallërimin e Sheshit Skënderbeu në Tiranë*.

- Rasti i parë i takon *Studios MVRDV*
- Rasti i dytë *MAP Architects*, dhe
- Rasti i tretë shqyrton projektin e *Architecture Studio*.

### V. ANALIZA URBANE-ANALIZA NE SHKALLE URBANE

“Qyteti funksionon si një organizëm i gjallë dhe si të tillë duhet ta konsiderojmë dhe po si të tillë duhet ta trajtojmë.” Në vazhdim studimi thellohet në analizimin e Prishtinës që nga rangi i qytetit duke ndjekur rrjedhjen logjike të zbritjes drejtë shesheve në fjalë. Pjesa e parë e analizave e trajton *Qytetin* në tërësinë e tij duke filluar me:

- Lindja, shtrirja dhe rritja e qytetit, (Fig. 5.1)
- Tekstura Urbane (Fig. 5.2)
- Funksionet dhe zonat në kuadër të qytetit
- Thurja e rrjetit rrugorë

- Evidentimi dhe potenciali i nyjeve urbane
- Shenjat/Sinjalet urbane
- Hapësirat natyror-hapësirat e gjelbra
- Trafiku urban rrugorë
- Transporti i lehte në Binare (TLB)
- Transporti alternative
- Rrjeti i këmbësorëve dhe i gjelbërimit,

### VI. PLATFORME PËR ZHVILLIMIN E QYTETIT-VIZIONI I QYTETIT

Pas hartimit të përfundimeve nga këto analiza erdha deri tek propozimi i një *Platforme për zhvillimin e Qytetit*. Platformë e cila përfshinë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm si dhe konsiderimet e dizajnit urban në jetësimin e kësaj platforme. Në saje të së cilës në fund dhe definohet *Vizioni për Prishtinën*: “Prishtina qendër universitare-kulturore rajonale dhe e administratës shtetërore, udhëheqëse në proceset zhvillimore të qëndrueshme duke ofruar jetë kualitative dhe ardhmëri të sigurtë”.

### VII. PROPOZIME NE KUADER TE QYTETIT. SATELITET – DY QENDRA TE REJA URBANE NE KUADER TE PRISHTINES SE NESERME

*KASTRIOTOKOSOVA DHE LYPJANI*, janë dy qytetet plotësuese dhe satelite të Prishtinës. Koncepti i tyre bazohet në supozimin e koncentrimin dhe krijimit të qendërve të reja duke bërë kështu të mundshme të ndërhyhet ndaj shpërhapjeje urbane dhe rritjes së qytetit pa kriterë. Ndonëse si e tillë kjo ide do të tingëllojë si ide utopike, por, mendoj që rimenaxhimi i shpërhapjeve urbane, rigrupimi i tyre dhe vendosja në hapësira të reja me potencial kthimi në hapësira urbane, do të ndihmojë që qyteti i tanishëm i Prishtinës, të çlirohet nga mbingarkimet - dhe si i tillë, *Qendra* e tij do të shndërrohet në zonë këmbësorësh.

Me pastaj vazhdojnë analizat në kuadër të Shesheve:

- Kufiri i zones së trajtuar
- Analiza historike
- Aktivitetet dhe funksionet
- Shfrytëzimi i hapësirës publike
- Dyshemeja urbane
- Arkitektura në ndryshim

### VIII. PERSHKRIMI I PROJEKTIT – PJESA TEKSTUALE. FILOZOFIA E RIKONCEPTIMIT – TEKNIKA E SHTESEZIMIT

Shkrimi në fjalë tenton të bëjë një shpjegim të shkurtër njoftues e kronologjik të asaj që sot quhet “layering” apo teknika e shtresëzimit. *Teknika e shtresëzimit*, apo *Katshmëri informacionesh*, sot përdoret mjaft dhe është pranuar tashmë si një ndër teknikat më gjithëpërfshirëse, domethënëse dhe frydhenëse të aplikimit të *leximeve* nga ambienti ekzistues dhe shfrytëzimi i tyre si elemente shtytëse në hartimin e

dizajnimeve konkrete për ambientin në të cilin ndërhyhet. Si lindi?, kush e përdori i pari si metodë projektimi?, si funksionon? e fakte tjera do të shtjellohen më poshtë. Për të kaluar më pastaj në fund tek aplikimi i kësaj metode tek rasti im konkret – Rikonceptimi dhe ndërhyrja në sheshet Zahir Pajaziti, Bulevardi Nënë Tereza, Sheshi Nënë Tereza dhe Sheshi Skenderbeu në Prishtinë

#### IX. SHESHI BOSHT-PRISHTINE

Po e njeta *Teknikë apo metodologji*, është përdorë dhe në rikonceptimin dhe ndërhyrjet në sheshin Zahir Pajaziti, Bulevardi Nënë Tereza, Sheshi Nënë Tereza, Skënderbeu dhe sheshin Pavarësia. Si bazë nga *leximet* e ambientit (terrenit) janë përvetësuar katër shtresëzime (lyera) të veçantë, të cilët në vetvete përmbajnë informacione të ndryshme, lidhja dhe hibridizimi i të cilave ka gjeneruar dizajnin përfundimtarë të dukjes së re të shesheve në fjalë.

*Shtresëzimi (layeri) i parë* ka të bëjë me historinë. Nga analiza historike janë marrë *gjurmët e bjekteve paraekzistuese*, si dhe *gjurmët e lumit të varrosur* të cilat më pas janë përkthyer në elemente figurative të trajtimit të dyshemesë urbane, por jo vetëm figurative, ato pasqyrojnë edhe kualitete natyrore ambientale siç është rasti i përdorimit të ujit. Më konkretisht, gjurmët e objekteve paraekzistuese, janë risjellë në skenë në mënyrë tashmë të abstraguar, në formën e një vije të thyer e të lakuar e cila përshkon gjithë gjatësinë e shesheve, dhe vende vende kjo vijë (me gjerazi prej 2m) thellohet në sipërfaqen e sheshit duke akumuluar në vetvete aty këtu dhe bazene të cekëta uji, duke e risjellë kështu dhe njëherë idenë e lumit të dikurshëm të Vellushës i cili tashmë i varrosur vazhdon udhëtimin e tij larg syve të njerëzve. Furnizimi me ujë i bazeneve bëhet po nga i njëjti lum i cili mu tek ndërtesa e *ish Unionit* e përshkon të gjithë gjerësinë e Bulevardit Nënë Tereza. Po nga e njëjta shtresë (layer), është përvetësuar dhe ideja e Çarshisë së dikurshme të mbuluar e sot të asgjësuar, duke u risjellë gjithmonë në mënyrë të abstraguar tashmë në një strehë xhami me efekte positive ambientale ekologjike (në të cilën janë të instaluar panele diellore të formësuar përgjatë gjithë gjatësisë së strehës), e cila mbulon dhe përshkon gjithë *aksin e shoppingut* për gjatë gjithë gjatësisë së shesheve, duke filluar prej *Zahir Pajaziti* dhe përfunduar tek sheshi *Skënderbeu*, duke vazhduar më pastaj në mes të ndërtesës së *Qeverisë* dhe *Parlamentit*, ku dikur saktësisht ndodhej dhe kompleksi i dyqaneve të *Çarshisë së mbuluar*.

*Shtresëzimi i dytë* ka të bëjë me vijat e lëvizjes (flukset) aktuale të lëvizjes të cilat në kontakt me *Shtresëzimin e tretë* që ka të bëjë me izohipsat e terrenit (gjithmonë në sensin e abstraguar) gjenerojnë hapësirat të cilat shënojnë dhe *Shtresëzimin e katërt* dhe të fundit, atë të gjelbërimit. Poashtu, ndërhyrja e shtresës së gjelbërimit në shtresëzimin e izohipsave krijon oazat e gjelbërta të cilat poashtu ndjekin tërë gjatësinë – nga sheshi Zahir Pajaziti për tek Sheshi Nënë Tereza duke bërë kështu dhe një lidhje të menduar me element

mikrouurban të dy shesheve në fjalë. Përderisa, izohipsat vetë shndërrohen në ndriçim horizontal të dyshemesë urbane në tërë sipërfaqet e pllakosura të shesheve.

Kështu pra, nga mbivendosja e *shtresëzimeve paraekzistuese* dhe të *shtresëzimeve aktuale* erdha deri tek një rikonceptim figurativ dhe logjik i dizajnit të përgjithshëm të shesheve, duke mos harruar dhe marrë parasysh edhe funksionet gjegjëse për të cilat do flasim pak më poshtë.

Kështu jam munduar që procesi i gjenerimit të projektit në *dizajnin urban* të përmbajë në vete dhe një proces logjik të mendimit duke mos e lënë asesi anash dhe *gjuhen e leximit* me të cilën na flet çdo ambient – po patëm veshë për të dëgjuar.

#### X. KONCEPTI - SHESHI BOSHT

Qëllimi i konceptit fillestar është ai i trajtimit të *Shesheve Zahir Pajaziti, Nënë Tereza, Skënderbeu si dhe sheshi Pavarësia* si një tërësi pothuajse unike që ka lind dhe vazhdon të zhvillohet në një *bosht qendror* në kuadër të zembrës së qytetit. Trajtimi i të katër shesheve si një tërësi unike, por me identitete të theksueshme dhe të dallueshme njëherit është dhe qëllimi kryesor i projektit tim. Si i tillë, projekti tenton që këtë *bosht* ta shndërroj në *Sheshin Kryesorë* (qendrorë) të kryeqytetit Prishtina. Nëse *Qendra e qytetit është identifikuese e denjë e një qyteti, atëherë sheshi kryesor do të jetë kualiteti primar e themelor i qendrës së qytetit*. Thënë më ndryshe në mënyrë krahasimore duke treguar rëndësinë që do ketë ky shesh në kuadër të qytetit por edhe të shtetit, mund ta përkufizojmë në sloganin: *kryeqyteti për shtetin – si sheshi qendrorë për kryeqytetin*.

Interferimi me pëlhurën urbane të qytetit të Prishtinës prodhon projektin ikonë të sheshit. Ky proces që gjeneron një identitet formal të veçantë dhe domethënës, të aftë të veprojnë si një referencë e vërtetë urbane, një tregues për qëllimet strategjike të një *kryeqyteti* i cili, gjatë përjasjes për një integrim të plotë në *Komunitetin Evropian*, e gjen veten në një situatë ku duhet të pranojë veçantitë e tij, në mënyrë që të mos vuajë proceset e pashmangshme entropike. Për këtë arsye projekti përqendron mjaft vëmendje në komunikimin dhe njohjen.

Në nivelin kryesor kompozicional projekti lartëson drejtimet e shumta të pëlhurës urbane, por njëkohësisht ruan edhe imponimin e një-drejshmërisë së ngurtë, e cila bënë që sheshi (tashmë unifikimi i shesheve të cekura më lartë) të merr primatin e *boshtit qendrorë* të qytetit. Në të njëjtën kohë ngre nevojën për të mbrojtur elementët më domethënës të kujtesës historike të formës urbane të Prishtinës.

Koncepti i projektit e konsideron zbrazëtinë si një vlerë urbane, përmbi të gjitha në dritën e rritjes domethënëse të dendësisë në Prishtinë; ai ri-kap „pikën zero“ të qytetit dhe horizontalitetin e tij, pa ndërtuar volume të reja; përkundrazi ai operon në brendësi të qytetit, duke zbritur në një gërmim - *Teatri i vallëzimit*, i paraparë me këtë projekt, pjesa më e

madhe e të cilit zhvillohet nën tokë, duke u bazuar në gjykimin e pamundësisë për të përjetuar Prishtinën nga nivele nën tokë.

Projekti gjithashtu përcakton një nivel domethënës parku, edhe në formë kopshtesh edhe vendesh të gjelbëruara me pemë; të unifikuar me prezencën e ujit, si rrjedhojë e qëllimit për të sjellë natyrën, në të gjithë format e mundshme të saj në shesh, në mënyrë që të kritikojë dyzimin mes asaj që njeriu ndërton dhe natyrës.

Projekti është drejtuar nga dëshira për të projektuar dhe prodhuar një hapësirë publike që ndryshon me kohën, një metronomi të jetës urbane, të aftë të përcaktojë ritmet dhe të shoqërojë rrahjet e saj; një hapësirë publike me trajta të ndryshueshme dhe në harmoni me shprehjen maksimale të zhvillimit të ardhshëm, evolucionin dhe rritjen e qytetit të Prishtinës. Për të ndjekur

këtë objektiv projekti ofron maksimumin e fleksibilitetit, duke siguruar që prezenca e një aktiviteti nuk e paragjykon mundësinë e përdorimit të të njëjtës hapësirë për qëllime të ndryshme

në kohë të ndryshme.

Sheshi është projektuar me një nivel kuptimplotë të temëzimit funksional, si shumë dhe bashkëveprim reciprok i hapësirave të dedikuara, për të përftuar një nivel të lartë funksionimi shumëpolësh, të aftë të reflektojë dhe prezantojë kompleksitetin e realitetit urban, në opozitë të qartë me mundësitë e ofruara nga një hapësirë e pafund, e paanshme dhe homogjene. Duke i dhënë ndoshta pak më tepër hapësirë përmbajtjeve të shtuara kulturore të cilat bëjnë që dhe vizioni i sheshit të shkoj përshtati me vizionin e përgjithshëm të kryeqytet Prishtina si qendër universitare-kulturore rajonale dhe e administratës shtetërore, udhëheqëse në proceset zhvillimore të qëndrueshme duke ofruar jetë kualitative dhe ardhmëri të sigurt. Projekti mohon çdo mundësi për ta bërë sheshin një monument, duke favorizuar konceptin e argëtimit, duke krijuar një hapësirë që është përmbledhje e eksperiencave të shumëfishta- perceptuale, njohëse, fizike, sociale, etj.

Projekti, i ngjashëm me një manifest, i përket një strategjie të marketingut urban, pjesë e konkurrencës aktual reklamues që zë vend midis kryeqyteteve të ndryshme evropiane, i cili e paraqet sheshi qendror të Prishtinës si një imazh të ri dhe thelbësisht të dallueshëm. Marketingu i qytetit varet shumë prej ndërtimit, komunikimit dhe menaxhimit të imazhit të qytetit, imazhi i qendrës së re të qytetit të Prishtinës me këtë projekt është bërë lehtësisht i komunikueshëm, i dallueshëm dhe i gëzueshëm.

## BIBLIOGRAFIA

- [1] Plani Studimor Urban i Prishtinës, (2002). KK. Prishtinë
- [2] Plani Rregullues Urban “Qendra”, (2002). KK. Prishtinë
- [3] Department for Transport. (2007). *Manual for streets*. London: Thomas Telford Ltd.
- [4] Environment, P. b. (2008). *Creating successful masterplans. Creating successful masterplans*, 159.
- [5] Government, D. f. (2006). *Preparing Design Codes*. London: RIBA Publishing.
- [6] W.-S. Lu, and “Design of FIR filters with discrete coefficients: SDP relaxations approach”, *Circuits and Systems, 2001. ISCAS 2001. The 2001 IEEE International Symposium on*, pp.297,300 vol. 2, 2001
- [7] Lerner, J. (n.d.). *Sings of the city. Sing of the city*, 50.
- [8] Planning, T. a. (April 2005). *Supplementary Planning Document / Designing out Crime*. London: London Borough of Sutton.
- [9] Lynch, K. (1990). *Image of the City*. London, England: The M.I.T. Press.
- [10] Schuls, C. N. *Genius Loci*. New York: Rizzoli.
- [11] Cullen, G. (2000) *The Concise Townscape*. Great Britain. Architectural Press
- [12] Zucker, P. (1970) *Town and Square: From the Agora to the Village Green*. M.I.T. Press
- [13] Carmona, M. Heath, T. Oc, T. Tiesdell, S.(2003) *Public Places-Urban Spaces*. Great Britain. Architectural Press
- [14] Madanipour, A. (2007) *Designing the City of Reason. Foundations and frameworks*. Great Britain. Taylor & Francis e-Library
- [15] De Bure, G. (2003) *B. Tschumi*. New York: Rizzoli.
- [16] Koolhaas, R. (2001) *Delirious New York*. Milano, Electa.
- [17] Carmona, M. Tiesdell, S. (2007) *Urban design reader*. Great Britain. Architectural Press
- [18] Gjinolli, I. (2005). *Ligerata nga Dizajni Urban*. Prishtina: FNA - Universiteti i Prishtinës.
- [19] Dhamo, MSc. (2009). *Analiza Territoriale*. Tirana: Universiteti Polis.
- [20] E. Fagu (2009). *Analizë arkitektonike*. Tirana: Universiteti Polis
- [21] Deda, L. (2010). *Leksione nga Dizajni Urban*. Tirana: Universiteti Polis.
- [22] Faja, E. Prof. Dr. (2005). *Arkitektura e Pejshazhit*. Tirana: Universiteti UFO.
- [23] *FORUM A+P (1-6)*. Tirana: Universiteti Polis (B. Aliaj, S. Dhamo, D. Shutina).
- [24] Grup autorësh, Hapësira qytetare drejt Fundit të Tranzicionit. *Këndvështrime filozofike dhe teknike*. Tiranë: Universiteti Polis.
- [25] Llonçari, Xh. A. (2004). *Arkitektura dhe Urbanizmi Sinergjik*. Prishtinë: Xhelal Llonçari.
- [26] Skodra, Z. (1984) *Qyteti shqiptar gjatë rilindjes kombëtare*. Tiranë: Akademia e shkencave e RRPSSH, institute i histories.
- [27] CHWB Kosovo office. (2008) *Heritage of Prishtina*, Prishtina: CHWB – Cultural Heritage without borders, Kosovo
- [28] Sylejmani, Sh. (2011) *Prishtina ime*. Prishtinë: Java multimedia production